

Vendimi 2020/KD01

Data: 12.10.2020

VENDIMET E KOMISIONIT DISIPLINOR TRAJTIMET DISIPLINORE

Komisioni Disiplinor, i përbërë nga: 1) Sevem Gjinaj (kryesuese), 2) Ylber Shamolli (anëtar), Vërshim Hatipi (anëtar), në përputhje me pikën 17.2.3. të rregullores 03#, më 06 tetor 2020 kanë trajtuar ankesat e fundit të pranuar në FTK dhe ka marr këto vendime:

Në çështjen e ankesës ndaj referit Arzen Rifati

Ankesa e pranuar nga tensiti Fresk Sylhasi më 26.08.2020, ndaj referit Arzen Rifati për mungesën e aplikimit të standardeve të referimit (matjen e rrjetës), para turneut “Rilindja Adult 2020” të datës 13-16 gusht 2020.

VENDIM

Aprovohet si e bazuar ankesa e lartpërmendur, ndaj së cilës merret vendimi për shqiptimin e masës “vërejtje me shkrim”, ndaj referit Arzen Rifati.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor pas trajtimit të ankesës së tenistit Fresk Sylhasi ndaj referit Arzen Rifati për mos matjen e rrjetës para turneut “Rilindja Adult 2020”, e që ka rezultuar të jetë më lartë se niveli i lejuar me rregullore, dhe përgjigjes së pranuar nga referi Arzen Rifati i cili ka pohuar veprimin e bërë ka vlerësuar si të bazuar ankesën e pranuar nga Sylhasi.

Komisioni Disiplinor merr vendim që referit Rifati të i shqiptohet masa “vërejtje me shkrim” duke u bazuar në pikën e poshtëpërmendur:

1. Veprimi i referit është vlerësuar të jetë lëshim i çastit;

Në çështjen e ankesës ndaj referit Gëzim Mehmedi

Ankesa e pranuar nga lojtari Arzen Rifati më 21.09.2020 ndaj referit Gëzim Mehmedi për përcaktimin e bartëseve dhe hedhjen e shortit jashtë rregullave në fuqi për garat e vetranëve, në turneun “Rilindja Seniors 35+” i datës 18-20 shtator 2020.

VENDIM

Aprovohet si e bazuar ankesa e lartpërmendur, ndaj së cilës merret vendimi për shqiptimin e masës “vërejtje me shkrim”, ndaj referit Gëzim Mehmedi.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor ka trajtuar ankesën e lojtarit Arzen Rifati dhe përgjigjen e referit Gëzim Mehmedi ndaj veprimit të bërë në turneun “Rilindja Seniors 35+ 2020” gjatë përcaktimit të bartëseve dhe hedhjes së shortit jashtë rregullave në fuqi.

Komisioni Disiplinor merr vendim që Gëzim Mehmedit të i shqiptohet masa “vërejtje me shkrim” duke u bazuar në pikat e poshtëpërmendura:

1. Veprimi i referit është vlerësuar të jetë lëshim i çastit;
2. Rregullat aktuale për hedhjen e shortit tek seniorët janë jo mirë të definuara.
3. Përcaktimi i bartëseve do të qartësohet pas hedhjes në fuqi të rregullores për gara #05 me të cilën do të mënjanohe problemet e ngjashme.

Në çështjen e ankesës ndaj referit Rifat Kasapolli

Ankesa e pranuar nga Komisionerja e Garave- Mërgime Mula më 08.09.2020, ndaj referit Rifat Kasapolli për mungesën në angazhimin dhe përfundimin e punës me përgjegjësi në turneun “HotShot KIDS 2020” i datës 05-06 shtator 2020.

VENDIM

Aprovohet si e bazuar ankesa e lartpërmendur, ndaj së cilës merret vendimi për shqiptimin e masës “vërejtje me shkrim dhe gjobë Financiare”, ndaj referit Rifat Kasapolli.

ARSYETIM

Komisioni Disiplinor ka trajtuar ankesën e parashtruar nga Komisionerja e Garave- Mërgime Mula ndaj referit Rifat Kasapolli për mungesën në angazhimin dhe përfundimin e punës me përgjegjësi në turneun “HotShot KIDS 2020” i datës 05-06 shtator 2020. Pala është ftuar të dërgoi në mënyrë elektronike përgjigje ndaj ankesës por i njëjti nuk është deklaruar.

Komisioni Disiplinor merr vendim që Rifat Kasapolli të i shqiptohet masa “vërejtje me shkrim dhe gjobë financiare me gjysmën e mëditjes dy ditore” duke u bazuar në pikat e poshtëpërmendura:

1. Lëshime të tilla janë raportuar edhe më parë, andaj nuk vlerësohen të jenë të çastit.
2. Veprimet e tilla jo profesionale tregojnë jo seriozitet dhe dëmtojnë fuqishëm zhvillimin e tenisit;
3. Profesionalizmi, dhe mbajtja e përgjegjësisë janë dy shtyllat kryesore në të cilat çdo referë duhet të mbështetet;

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë ankese me shkrim në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet

Palëve dhe
Bordit

Komisioni Disiplinor

Sëvem Gjinaj
Ylber Shamolli
Vërshim Hatipi